

VENDIM

Projekt

NrDatë 2023

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.929, DATË 17.11.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË VEÇANTË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.35/2023 “Për kompetencat për përcaktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, nenit 45 të ligjit 9936/2018 “Pë menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 14 të ligjit 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”. me propozimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pika 9, e vendimit nr.929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, riformulohet si më poshtë vijon:

“Për vitin 2023, fondi i veçantë i institucioneve qendrore buxhetore dhe jo-buxhetore, institucioneve të vetqeverisjes vendore, njësive të Fondeve Speciale, institucioneve publike të krijuara me ligj të posaçëm, ndërmarrjeve dhe shoqërive tregtare me kapital mbi 50% shtetëror në varësi të institucioneve qendrore dhe vetqeverisjes vendore, nuk përdoret për veprimtari social-kulturore dhe shpërblimin e punonjësve. Ky përcaktim nuk zbatohet për :

- a) Punonjësit mbështetës organikë dhe me kontratë të përkohshme mbi 6-muaj, në njësitë e qeverisjes qendrore, të cilët shpërblehen në masën 10,000 lekë.
- b) Punonjësit e Policisë së Burgjeve si dhe punonjësit e tjerë civil të sistemit të burgjeve, përfshirë edhe punonjësit e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm te

Burgjeve, për të cilët masa e shpërblimit nuk tejkalon nivelin e një page mujore.

c) Punonjësit e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, të cilët shpërblehen deri në 50,000 lekë.”,

2. Efektet financiare për shpërblimin e punonjësve të sipërpërmendur përballohen nga:

- Fondet e lira në zërin e shpenzimeve të personelit të njësisë dhe nga Fondi i Veçantë, për punonjësit sipas pikës 1.
- Fondi Rezervë i Buxhetit , në masën 380,000,000 lekë për punonjësit sipas pikës 2.
- Fondet e veta të miratuara për vitin 2023, për punonjësit sipas pikës 3.

3. Ngarkohen njësitë e qeverisjes së përgjithshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare,, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletoren zyrtare.

K R Y E M I N I S T R I

E D I R A M A